



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR



PROCESVERBAL

**MBLEDHJA E DYTË E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË
APLIKIMEVE (KVA) PËR GBP 2025**

13 tetor 2025

Hapja e mbledhjes

Z.Sonil Frashëri, Këshilltar/MSHPV në cilësinë e Kryetarit të Vlerësimit të Aplikimeve hapi mbledhjen e dytë të Komisionit të Vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë. Në fjalën e tij hyrëse, ai falenderoi pjesëmarrësit për angazhimin e tyre dhe prezantoi përbërjen e komisionit si dhe pjesëmarrësit e pranishëm në këtë sesion. Më pas, ai paraqiti një përmbledhje të rezultateve paraprake të procesit të vlerësimit për treguesin që lidhet me **Planin Vendor të Mbarështimit të Pyjeve**.

Në vijim të sesionit, z. *Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar*, paraqiti në mënyrë të strukturuar procedurën administrative që ndiqet sipas Udhëzimit të Përbashkët nr.01, datë 11.07.2025, për shqyrtimin e aplikimeve të dorëzuara nga bashkitë. Ai theksoi gjithashtu rolin dhe përgjegjësitë e sekretariatit teknik në këtë proces. Më tej, z. Llavdaniti bëri një shpjegim të detajuar të të gjithë kriterëve që duhen përmblusur për Planin e Mbarështimit të Pyjeve dhe vijoi me paraqitjen e rezultateve paraprake të verifikimeve mbi dokumentacionin e dorëzuar nga bashkitë.

KONKLUZIONET PARAPRAKE MBI KRITERIN E PLOTËSISË

- Totali i aplikimeve → **28 bashki**
- Urdhri i MTM-së (brenda afatit) → **15 bashki**
- Dokumenti i Planit → **15 bashki**
- Vendimi i Këshillit Bashkiak → **15 bashki**
- Lidhja e publikimit në faqen zyrtare → **8 bashki**

Bashkia	Dokumenti i planit	Vendimi i Këshillit Bashkiak	Urdhri MTM (1 janar-17 shtator)	Link Publikimi	4 Kriteret sipas Udhëzimit
Cërrik	✓	✓	✓	✓	✓
Dropull	✓	✓	✓	✗	✗
Elbasan	✓	✓	✓	✓	✓
Finiq	✓	✓	✓	✓	✓
Fushë-Arrëz	✓	✓	✓	✗	✗
Kamëz	✓	✓	✓	✓	✓
Kolonjë	✓	✓	✓	✗	✗
Librazhd	✓	✓	✓	✓	✓
Mat	✓	✓	✓	✗	✗
Pogradec	✓	✓	✓	✗	✗
Prrenjas	✓	✓	✓	✓	✓
Pukë	✓	✓	✓	✗	✗
Shijak	✓	✓	✓	✓	✓
Tepelenë	✓	✓	✓	✓	✓
Vau-Dejës	✓	✓	✓	✗	✗

Pas prezantimit të rezultateve, *Znj. Adelina Farriçi – Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë – Anëtare Komisioni* shtron pyetje për Lidhjen e publikimit në faqen zyrtare dhe konfirmon që bashkitë për të cilat i'u mungon link në fakt e kanë në faqet e tyre zyrtare.

Në lidhje me këtë konstatim *Znj. Arnela Hetoja – Specialiste e Performancës – Sekretariati Teknik* sqaron se gjithmonë në referencë të udhëzimit të përbashkët, sekretariati teknik ka për përgjegjësi të shqyrtoj dokumentacionin e përcjellë në AMVV nga vetë bashkitë. Për rrjedhojë, bashkive për të cilat iu mungon lidhja e publikimit është vlerësuar me **X** sepse publikimi ka të bëjë me Vendimin e Këshillit Bashkiak jo atë të planit vendor. Gjithashtu, vijon duke shpjeguar që për Planin e Mbarështimit të Pyjeve, kanë dorëzuar aplikim 28 bashki, me të paktën një dokumentacion. Ajo parashtron se **në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët, miratimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për periudhën 1 janar – 17 shtator, përbën kriterin themelor për konsiderimin e treguesit si të përmbushur, duke qenë autoriteti më i lartë miratues.** Rrjedhimisht, janë pasqyruar për vlerësimin paraprak vetëm ato bashki të cilat ju është miratuar plani vendor nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

15 Bashkitë: Cërrik, Dropull, Elbasan, Finiq, Fushë-Arrëz, Kamëz, Kolonjë, Librazhd, Mat, Pogradec, Prrenjas, Pukë, Shijak, Tepelenë, Vau-Dejës

Anëtarët e komisionit kanë zhvilluar diskutime të vazhdueshme mbi këtë çështje, duke iu referuar udhëzimit përkatës. *Z. Erton Krashta – Bashki të Forta/Helvetas* propozon shqyrtimin dhe verifikimin e mëtejshëm nga komisioni mbi lidhjen e publikimit.

Z. Frashëri sugjeron që, duke qenë se kriteret kryesore procedurale janë përmbushur tashmë nga bashkitë aplikuese, si dhe duke konsideruar faktin që vendimi i Këshillit Bashkiak është dorëzuar si dokument fizik, kriteri për publikimin mund të konsiderohet i plotësuar edhe në rastet kur bashkitë kanë publikuar planin vendor në vend të vetë vendimit të Këshillit Bashkiak. **Ai vijon duke pyetur anëtarët e komisionit nëse janë dakord me këtë sugjerim dhe të gjithë anëtarët u dakordësuan.**

Në vijim *Z. Ylli Hoxha – përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit – Anëtar Komisioni* thekson se **bashkia Finiq** ka dorëzuar dokumentacion të plotë sipas udhëzimit, por miratimi nga Këshilli Bashkiak dhe Ministria është në referencë të një ekonomie pyjore private, jo si një pronësi shtetërore e administruar nga bashkia. Ky konstatim ngriti shumë diskutime ndërmjet anëtarëve pasi u ndanë këndvështrime të ndryshme. Udhëzimi nuk përcakton shprehimisht llojin e ekonomisë pyjore por nga ana tjetër, aplikimi i bashkisë Finiq bie në kundërshtim me funksionin bashkiak, duke qenë se nuk është një plan vendor por privat. Gjithashtu *Z. Hoxha* vë në dukje se **bashkia Dimal** ka një plan mbarështimi të miratuar, për të cilën u sugjerua rishqyrtimi i dokumentacionit nga ana e AMVV-së, pasi nuk figuron pjesë e listës paraprake.

Znj. Olta Caca- Drejtore e Drejtorisë së Statistikës dhe Performancës konfirmon rishqyrtimin nga ana e AMVV-së dhe sqaron se gjatë dorëzimit të dokumentacionit, praktika e bashkisë Dimal është dorëzuar pranë MSHPV-së, e për pasojë mund të ketë ndodhur ndonjë problem teknik nga përcjellja shkresore dhe/ose përmbajtja voluminoze e dokumentacioneve të dorëzuara.

Mbyllja e Mbledhjes

Z.Frashëri, në referencë të diskutimeve të mësipërme, sugjeron që të verifikohen nga ana e sekretariatit teknik vlerësimi sa i takon **lidhjes së publikimit**, të verifikohet rasti i **bashkisë Dimal** dhe të dërgohen materialet e përditësuara me qëllim dakordësinë nga ana e anëtarëve të KVA-së e cila do konfirmohet me e-mail zyrtar. Gjithashtu do merret dhe vendimi përfundimtar sa i takon dokumentacionit të përcjellë nga **bashkia Finiq**.

VERIFIKIMI SIPAS SUGJERIMEVE TË KVA-SË.

Sekretariati Teknik ndoqi sugjerimet e KVA-së dhe më poshtë do të gjeni shqyrtimin e dokumentacionit për Planin e Mbarështimit të Pyjeve nga Sekretariati Teknik – AMVV.

- Totali i aplikimeve → **28 bashki**
- Urdhri i MTM-së (brenda afatit) → **16 bashki**
- Dokumenti i Planit → **16 bashki**
- Vendimi i Këshillit Bashkiak → **16 bashki**
- Lidhja e publikimit në faqen zyrtare → **16 bashki**

Bashkia	Dokumenti i planit	Vendimi i Këshillit Bashkiak	Urdhri MTM (1 janar-17 shtator)	Link Publikimi	4 Kriteret sipas Udhëzimit
Belsh	✓	✗	✗	✗	✗
Cërrik	✓	✓	✓	✓	✓
Dimal	✓	✓	✓	✓	✓
Divjakë	✓	✓	✗	✓	✗
Dropull	✓	✓	✓	✓	✓
Elbasan	✓	✓	✓	✓	✓
Finiq **	✓	✓	✓	✓	✓
Fushë-Arrëz	✓	✓	✓	✓	✓
Gramsh *	✗	✗	✗	✗	✗
Has *	✗	✗	✗	✗	✗
Kamëz	✓	✓	✓	✓	✓
Kolonjë	✓	✓	✓	✓	✓
Kuçovë	✓	✓	✗	✓	✗
Librazhd	✓	✓	✓	✓	✓
Lushnje	✗	✓	✗	✗	✗
Mat	✓	✓	✓	✓	✓

Mirëditë*	X	X	X	X	X
Patos	✓	✓	X	X	X
Peqin*	X	X	X	X	X
Pogradec	✓	✓	✓	✓	✓
Prrenjas	✓	✓	✓	✓	✓
Pukë	✓	✓	✓	✓	✓
Pustec	✓	✓	X	X	X
Roskovec	✓	X	X	X	X
Shijak	✓	✓	✓	✓	✓
Shkodër*	X	X	X	X	X
Tepelenë	✓	✓	✓	✓	✓
Vau-Dejës	✓	✓	✓	✓	✓

* Këto bashki rezultojnë me Urdhrin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit jashtë afatit të përcaktuar, sipas [Udhëzimit të Përbashkët Nr.01, datë 11.07.2025.](#)

** Bashkia Finiq ka dorëzuar dokumentacionin sipas Udhëzimit, por miratimi i Planit të Mbarështimit i përkon një ekonomie pyjore private në pronësi të familjes Mehmeti, jo në kompetencë të bashkisë.

VLERËSIMI PARAPRAK NGA KVA MBI KUALIFIKIMIN E BASHKIVE PËR PLANIN E MBARËSHTIMIT

Vlerësimi i KVA për Planin e Mbarështimit të Pyjeve		
Nr.	Bashkia	Kualifikohet për kriterin e cilësisë në përputhje me udhëzimet/kërkesat e MTM
1	Belsh	Jo
2	Cërrik	Po
3	Dimal	Po
4	Divjakë	Jo
5	Dropull	Po
6	Elbasan	Po
7	Finiq	Jo
8	Fushë-Arrëz	Po
9	Gramsh	Jo
10	Has	Jo
11	Kamëz	Po
12	Kolonjë	Po
13	Kuçovë	Jo
14	Librazhd	Po
15	Lushnje	Jo
16	Mat	Po
17	Mirëditë	Jo
18	Patos	Jo
19	Peqin	Jo
20	Pogradec	Po
21	Prrenjas	Po
22	Pukë	Po
23	Pustec	Jo
24	Roskovec	Jo
25	Shijak	Po
26	Shkodër	Jo
27	Tepelenë	Po
28	Vau-Dejës	Po